

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a.

31 Dhjetor 2012

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur Bookmark not defined.	Error!
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse Bookmark not defined.	Error!
Bilanci i Gjendjes Bookmark not defined.	Error!
Pasqyra e Ndryshimeve në Ëkuitet Bookmark not defined.	Error!
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	5
Shënimet e Pasqyrave Financiare	6

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin dhe Aksionarët e Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si "Kompania" apo "FSKP") që përbëhen prej pozicionit financiar deri më 31 Dhjetor 2012, pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrës së rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe përmbledhjen e politikave kryesore kontabël dhe shënimeve tjera sqaruese.

Përgjegjësitë e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontroll të brendshëm që menaxhmenti konsideron të nevojshëm për mundësinë e pregaditjes së pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë nga ndonjë mashtrim ose gabim.

Përgjëgjësia e Auditorit

Përgjëgjësi e jona është të shprehim një mendim për këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë pasqyrat financiare të lira nga gabimet materiale.

Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Në bërjën e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant për pregaditjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmëria e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia audituese që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e duhur që të ofrojë bazë për mendimin tonë të auditorit.

Mendim

Për mendimin tonë pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë më 31 Dhjetor 2012, dhe performancën financiare të sajë, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin e përfunduar, në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje tjetër

Pasqyrat Financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011, janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një mendim të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare më 11 Prill 2012.

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Shënimet	(Në Euro)	
		Viti që përfundon më 31 Dhjetor	
		2012	2011
Të hyrat e gjeneruara nga menaxhimi i Fondit			
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 1		63,715	57,948
Tarifa e menaxhmentit për Fondin 2	4	10,834	28,391
Tarifa hyrëse		11,197	12,248
Tarifa e daljes		1,310	1,329
		87,056	99,916
Rezultatet financiare, neto			
Të hyrat e interesit	5	7,912	69,878
Të hyrat e interesit nga letrat më vlerë me maturitet fikse		9,546	19,813
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë të gatshme për shitje			324
		17,458	90,015
Të hyrat tjera	6	552	7,187
Shpenzimet operative	7	(111,220)	(215,906)
(Humbja)/Fitimi para tatimit në të ardhura		(6,154)	(18,788)
Shpenzimet e tatimit në të hyra	8	-	-
(Humbja)/Fitimi për vit		(6,154)	(18,788)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse			
Asetet financiare të gatshme për shitje			
- fitimi neto i përealizuar i vitit actual			-
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse			-
Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithpërfshirëse		(6,154)	(18,788)

Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 26, të cilat formojnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënimet	(Në Euro) Më 31 Dhjetor	
		2012	2011
Asetet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	9	5,064	29,526
Letrat me vlerë të mbajturaderi në maturim	10	333,592	315,491
Prona dhe pajisjet	11	5,524	7,227
Asetet e paprekshme	12	14,768	16,045
Të arkëtueshmet tjera	13	23,776	26,205
Total asetet		382,724	394,494
Detyrimet			
Detyrimet tregëtare dhe tjera	14	6,849	12,465
		6,849	12,465
Ekuiteti			
Kapitali aksionar		400,000	400,000
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		(24,125)	(17,971)
	15	375,875	382,029
Totali i Detyrimeve dhe Ekuitetit		382,724	394,494

Këto pasqyra Financiare janë aprovuar nga Bordi Menaxhues më 22 Mars 2013 dhe janë nënshkruar në emër të,

Mr. Bajram Bajrami,
Drejtor Menaxhues

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

	Kapitali aksionar	Pagesa shtesë në kapital	Rezervat	Humbja e akumuluar	Në Euro Totali
Më 01 Januar 2011	4,000,000	-	5,386	50,817	4,056,203
Tërheqja e kapitalit	(3,600,000)	-	-	-	(3,600,000)
Dividendët e paguar	-	-	-	(50,000)	(50,000)
Humbja e vitit	-	-	-	(18,788)	(18,788)
Riklasifikimi i fitimit dhe humbjes	-	-	(5,386)	-	(5,386)
Më 31 Dhjetor 2011	400,000	-	-	(17,971)	382,029
Më 01 Januar 2012	400,000	-	-	(17,971)	382,029
Humbja e vitit	-	-	-	(6,154)	(6,154)
Më 31 Dhjetor 2012	400,000	-	-	(24,125)	375,875

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqe 6 deri 26 të cilat formojnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Shënime	(Në Euro)	
	Viti i përfunduar 31 Dhjetor 2012	2011
Aktivitetet Operative		
Humbja e vitit	(6,154)	(18,788)
Zhvlerësimi/Amortizimi	12,504	41,304
Fitimet nga shtija e pasurisë dhe pajisjeve	-	(2,577)
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë të gatshme për shitje	-	(324)
Të ardhura të tjera	(552)	(4,610)
Të ardhurat e interesit, neto	(17,458)	(89,691)
Lirimi i te hyrave të shtyera të menaxhimit	-	(3,575)
Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i Fondit	(87,056)	(96,341)
<i>Rrjedha e parasë para ndryshimeve në asetet operative</i>	<i>(98,716)</i>	<i>(174,602)</i>
<i>Ndryshimet në asetet operative</i>		
(Maturimi)/blerja e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	(18,200)	1,821,708
Rritja në të arkëtueshmet e tjera	(4,159)	(8,729)
Detyrimet tjera	(5,616)	383
<i>Rrjedha e parasë pas ndryshimeve në asetet operative</i>	<i>(126,691)</i>	<i>1,638,760</i>
Interesi i pranuar	18,111	135,078
Tarifat e pranuar të menaxhimit me fonde	93,642	87,834
	(14,938)	1,861,672
Aktivitetet Investuese		
(Blerja)/Shitja e ndërtesave dhe pajisjeve	(9,524)	204
Investimi në letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	1,696,330
Investimi në letrat me vlerë të gatshme për shitje	-	99,952
Dividendët e paguar	-	(50,000)
	(9,524)	1,746,486
Aktivitetet Financuese		
Tërheqja e Kapitalit	-	(3,600,000)
	-	(3,600,000)
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalentet e parasë	(24,462)	8,158
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim	9	29,526
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fund	9	29,526

Pasqyra e rrjedhës së parasë të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 6 deri 26 të cilat formojnë një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

Shënimet e pasqyrave financiare

1 E përgjithshme

Fondi Sloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si “Kompania” ose “FSKP”) është themeluar si shoqëri aksionare më 29 Gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Kompania ka filluar operimet e saj më 04 Shtator 2006. Kompania gjendet në Rr.UCK, nr.50/2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Aksionarët kryesorë të Kompanisë janë Prva Group PLC, Slovenia dhe Dukagjini sh.p.k., Republika e Kosovës.

Aktivitetët kryesorë të Kompanisë janë si në vazhdim: menaxhimi i fondeve pensionale, përfaqësimi i tyre kundrejt palëve të treta si dhe aktivitetet tjera të lidhura me fondet pensionale.

Që nga zanafilla e saj deri në fillim-vit 2008, Kompania ka menaxhuar një fond pensional vullnetar (më tej referuar si ‘Fondi 1’). Gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2008, Kompania ka nënshkruar Marrëveshje me fondin në likuidim të sigurimit pensional plotësues të KEK-ut (më tej referuar si “KEK”) dhe fondit në likuidim të sigurimit pensional plotësues të PTK-së (më tej referuar si “PTK”) për menaxhimin e aseteve të tyre dhe pagesën e pensionit vjetor në çdo muaj pas planit të paracaktuar pensional të dhënë nga KEK-u dhe PTK-ja. Asetet e KEK-ut dhe PTK-së përbëjnë fondin e dytë pensional nën menaxhimin e FSKP-së (më tej referuar si “Fondi 2”).

Më 31 Dhjetor 2011, Kompania ka kryer aktivitetet e biznesit të saj me 4 punëtorë (2011: 5 punëtorë).

2 Politikat kontabël

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Këto politika janë zbatuar në përputhje me të gjitha vitet e prezentuara, përveç nëse është theksuar ndryshe.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) që janë lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e matjes të specifikuara nga SNRF-të për secilin lloj të asetit, detyrimit, të hyrave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes më plotësisht janë të përshkruara më poshtë në politikat kontabël.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitet e përfunduar më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro.

Ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë rregulluar për të qenë në përputhje me ndryshimet në prezantimin e vitit aktual.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalesje

Politikat kontabël për përgatitjen e pasqyrave financiare janë aplikuar në vazhdimësi nga ana e Kompanisë për vitet 2012 dhe 2011, duke marrë parasysh ndryshimet e mëposhtme të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat janë lëshuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BSNK). Kompania ka adoptuar ndryshimin e interpretimit të SNRF-vë dhe KIRFN nga 01 Janar 2012:

- **Amendamenti 1 i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar** « Hiperinflacioni dhe heqja e datave të fiksuara për adoptuesit për herë të parë». Amendamenti nuk zbatohet për pasqyrat financiare të Kompanisë.

- **Amendamenti 7 i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar** «Shpalesjet – Transferet e aseteve financiare »

Më 7.10.2010, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar një amendament të SNRF-vë 7 në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese që kërkohen kur asetet financiare janë transferuar. Dhënia e informacioneve shpjeguese lidhet me asetet financiare që janë transferuar dhe se a) entiteti nuk e njeh, b) entiteti e ka përfshirjen e vazhdueshme, c) entiteti nuk e njeh. Më ndryshimin e mësipërm, dhënia e informacioneve shpjeguese ekzistuese është rishikuar në mënyrë që të arrihet transparencë më e madhë në raportimin e transaksioneve të transferimit, veçanërisht ato që përfshijnë sekuritizimin e aseteve financiare.

Miratimi i amendamentit të mësipërm nga ana e Kompanisë nuk pritet të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj.

- **Amendamenti 12 i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit «Tatimi i shtyrë: Rimbullimi i aktiveve themelore»**

Më 20.12.2010, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar një amendament të SNK 12 në lidhje me mënyrën me të cilën tatimi i shtyrë duhet të llogaritet kur është e vështirë për të përcaktuar mënyrën e pritshme të rimbullimit të mjeteve themelore dhe mënyrën e rimbullimit të efekteve që ndikon në përcaktimin e bazës tatimore dhe shkallës tatimore. Në rishikimin e SNK 12, është sqaruar se kur një aktiv është klasifikuar ose si «Pronë e Investimeve» matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë ose si «Pronë, Impiante dhe Pajisje» matet duke përdorur modelin e rivlerësimit, ka një hipotezë të kundërshtueshme se shumica e mbajtur do të mbulohet tërësisht nga shitja, prandaj, për kalkulimin e tatimit të shtyrë norma përkatëse tatimore dhe baza tatimore duhet të përdoren. Megjithatë, është sqaruar se për rastet e pronave të investimeve, ky presupozim është i kontestueshëm nëse pasuria është e amortizuar dhe ajo mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është që të konsumojë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të trupëzuara në aktiv me kalimin e kohës, në vend se përmes shitjes.

Miratimi i amendamentit të mësipërm nga ana e Kompanisë nuk pritet të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalesje (Vazhdim)

Standardet e publikuara por akoma jo efektive dhe jo të adoptuara me herët

Standardet e publikuara por akoma jo efektive, nuk janë ende në fuqi në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Kompanisë janë të listuara më poshtë. Ky listim është i standardeve dhe interpretimeve të lëshuar, të cilat Kompania arsyeshmërisht pret të jenë të zbatueshme në një datë të ardhshme. Kompania synon të miratojë këto standarde kur të bëhen efektive.

- **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 10** «Pasqyrat Financiare të Konsoliduara»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara”. Objektivi i SNRF është që të vendosë parimet për paraqitjen dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara kur një entitet kontrollon një ose më shumë entitete tjera. Ndryshimi i madhë i sjellur nga SNRF 10 është një definim i ri i parimit të kontrollit. Kontrolli është bazë për përcaktimin se cilat subjekte janë të konsoliduar, pavarësisht nga lloji i entitetit. SNRF 10 zëvendëson kërkesat në lidhje me pasqyrat financiare të konsoliduara në SNK 27 “Pasqyrat e Konsoliduara dhe të Ndara Financiare” dhe gjithashtu zëvendëson KIS 12 “Konsolidimi – Entitetet për qëllime të vecanta”.

Standardi aktualisht nuk është i zbatueshëm për njësin ekonomike sikur që nuk ka ndonjë filialë të kontrolluar.

- **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 11** «Marrëveshjet e Perbashkëta»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Më 12 Maj 2011, Bordi I Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar SNRF 11 «Marrëveshjet e Përbashkëta» e cila përcakton parimet për raportimin financiar të njësive ekonomike që kanë një interes në marrëveshjet që janë të kontrolluara bashkërisht.

Standardi aktualisht nuk është i zbatueshëm për njësin ekonomike, sikur që nuk ka ndonjë filialë të kontrolluar.

- **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 12** «Shpalesja e interesave në Subjektet Tjera»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1.1.2013

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar SNRF 12 i cili përcakton informacionin që njësi ekonomike raportuese duhet të japë informacion shpjgues lidhur me interesat e saj në njësitë e tjera. Një interes në një entitet tjetër i referohet përfshirjes kontraktuale ose jo-kontraktuale që ekspozon një njesi ekonomike ndaj ndryshueshmërisë së kthimit nga kryerja e një njësie tjetër ekonomike. SNRF 12 liston informatat shpjguese të kërkuara në varësi të natyrës së interesit të subjekteve të tjera, dmth a) Filialet, b) Marrëveshjet e përbashkëta, c) Bashkëpunëtorët dhe d) Subjektet strukturore te pakonsoliduara.

Standardi aktualisht nuk është i zbatueshëm për njësin ekonomike sikur që nuk ka ndonjë filialë të kontrolluar.

- **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 13** «Matja me vlerën e drejtë»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Më 12.5.2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar SNRF 13 e cila:

- Përcakton vlerën e drejtë
- Vë në një kornizë të vetme SNRF për matjen e vlerës së drejtë dhe
- Kërkon dhënien e informacioneve shpjguese në lidhje me matjet e vlerës së drejtë

Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i këtij standardi në pasqyrat e saj financiare.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalesje (Vazhdim)

- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar i Kontabilitetit 1** «Prezantimi i zërave tjerë të Pasqyrës së të Ardhurave Gjithpërfshirëse»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.7.2012

Më 16.6.2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar një amendament të SNK 1 në lidhje me prezantimin e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse. Bazuar në amendament, zërat e të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të grupohen në ato që nuk do të riklasifikohen më pas në fitim ose në humbje dhe në ato që do të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje kur kushtet specifike janë plotësuar. Në rast se zërat e të ardhurave tjera përmbledhëse janë paraqitur para tatimit, tatimi duhet të paraqitet ndaras për secilin prej grupeve të mësipërme.

Miratimi i amendamentit të mësipërm nga kompania mund të qojë në ndryshime në prezantimin e pasqyrës së të ardhurave.

- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 19** «Përfitimet e Punonjësve»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar më 16.06.2011 SNK 19 të rishikuar. Standardi i rishikuar prezanton ndryshime të rëndësishme në lidhje me kontabilitetin e skemave të përfitimeve të përcaktuara. Ndryshimet kryesore janë si më poshtë:

- Njohja e menjëhershme e ndryshimeve në neto të detyrimeve për përfitime të përcaktuara. Prandaj, opsioni për të shtyrë fitimet dhe humbjet neto aktuale (qasja korridor) dhe koston e shërbimit të shkuar kur përfitimet nuk janë dhënë është shfuqizuar.
- Standardi i ri përcakton qartë njohjen e çdo komponenti të përcaktuar së koston së përfitimit. Në veçanti:
 - I. Kosto shërbimi njihet në fitim ose humbje
 - II. Interesi neto për detyrimet për përfitime të përcaktuara neto (aktiv) njihet në fitim ose humbje
 - III. Rimatja e detyrimit për përfitime të përcaktuara neto (aktiv) janë njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse. Ata nuk janë të riklasifikuar në fitim ose humbje në një periudhë të mëpasshme.
- Shpalesjet e kërkuara për planet e përfitimeve të përcaktuara janë rishikuar në mënyrë të lidhur më zhvillimet në standardet e tjera dhe veçanërisht në SNRF 7.

Veç kësaj standardi i ri e ndryshon kohën për njohjen e detyrimit që rrjedh nga përfitimet e ndërprerjes së marrëdhënieve.

Kompania vleron ndikimin e mundshëm nga miratimi i këtij standardi në pasqyrat financiare të saj.

- **Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 27** «Pasqyrat Financiare të veçanta»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Më 12 Maj 2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ndryshoi dhe rititulloi SNK 27. SNK 27 i ndryshuar përmban kontabilitetin dhe kërkesat për shënime shpjeguese për investimet në filiale, ndërmarrje të përbashkëta dhe bashkëpunëtorëve kur një njësi ekonomike përgatit pasqyrat financiare të veçanta. Investimet e mësipërme do të llogariten ose në kosto ose në përputhje me SNK 39 (ose SNK 9 nëse aplikohet) në pasqyrat financiare të veçanta të investitorit. Standardi i ndryshuar nuk ndryshon në thelb kërkesat përkatëse të kontabilitetit të cilat janë aktualisht të aplikueshme sipas SNK 27 "Pasqyrat Financiare të veçanta dhe të Konsoliduara".

Miratimi i amendamentit të mësipërm nga ana e Kompanisë nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të saj.

- **Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 28** «Investimet në Shoqëritë dhe Ndërmarrjet e Përbashkëta»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013. Standardi nuk është i zbatueshëm për Kompaninë.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

- **Amendamenti 32 i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit** «Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare», Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2014 dhe i **Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7** «Shpalosje – Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare», Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013

Më 16.12.2011, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi amendamentin e SNK 32 dhe SNRF 7 në lidhje me kompensimin e aktiveve financiare dhe pasiveve financiare. Amendamenti i SNK 32 ka të bëjë me shtimin e udhëzimit për zbatim në lidhje me të drejtën për të kompensuar, ndërsa amendamenti i SNRF 7 ka të bëjë më kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në lidhje me të njëjtën çështje.

Kompania vlerëson që ka ndikim të mundshëm nga miratimi i këtij standardi në pasqyrat financiare të saj.

- **Interpretimi 20** «Heqja e kostove në fazën e prodhimit të një miniere sipërfaqësore» Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013. Standardi nuk është i zbatueshëm për Kompaninë.
- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar** «Huatë qeveritare» Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1.1.2013. Standardi nuk është i zbatueshëm për Kompaninë.

- **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 9** «Instrumentet Financiare» Efektive për periudhat që fillojnë me ose pas 1.1.2015
Më 12.11.2009, SNRF 9: «Instrumentet Financiare» është lëshuar nga bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Standardi i ri është lëshuar si pjesë e fazës së parë të projektit për zëvendësimin e SNK 39; prandaj, objekti i fazës së parë është klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare. Sipas standardit të ri, instrumentet financiare duhet të klasifikohen në njohjen fillestare, ose me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë. Kriteret që duhet të konsiderohen për klasifikimin fillestar të aktiveve financiare janë si në vijim:

- I. Modeli i njësisë së biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare dhe
- II. Karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivëve financiarë.

Përveç kësaj, SNRF 9 lejon, në njohjen fillestare, instrumentet e kapitalit të klasifikohen me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithpërfshirëse. Opsioni përjashton instrumentet e kapitalit të mbajtura për tregtim. Për më tepër, në lidhje me derivatet e përfshira, nëse kontakti hibrid përmban një mori që është brenda fushës së SNRF 9, derivati i përfshirë nuk duhet të ndahet dhe trajtimi kontabël i kontaktit hibrid duhet të bazohet në kërkesat e mësipërme për klasifikimin e instrumenteve financiare.

Përveç kësaj, më 28.10.2008, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka lëshuar kërkesat e rishikuara lidhur me klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Sipas kërkesave të reja, të cilat janë të përfshira në SNRF 9, në rastin e detyrimeve financiare që janë përcaktuar fillimisht me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ndryshimi në vlerën e drejtë të pasivit duhet të njihet në fillim ose humbje me përjashtim të efektit të ndryshimit në riskun e kredisë së pasivit të cilat duhet të njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Për më tepër, më 16.12.2011 Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, me një amendament të ri të SNRF 9, transferon datën efektive të standardit prej 1.1.2013 në 1.1.2015.

Së fundi, duhet theksuar se për përfundimin e SNRF 9, finalizimi i teksteve lidhet me koston e amortizuar dhe llogaritjen e zhvlerësimit si dhe për kontabilitetin (hedge) mbrojtës në pritje.

Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i këtij standardi në pasqyrat financiare të saj.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.2 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 7** «Instrumentet Financiare–Shpalosjet»

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1.1.2015

Më 16.12.2011, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi amendamentin e SNRF 7.Me këtë amendament, informacionet shpjeguese janë shtuar lidhur më kalimin në SNRF 9.

Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i amendamentit në pasqyrat financiare të saj.

- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 10** «Konsolidimi i Pasqyrave Financiare **Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 12** «Shpalosjet e interesave në subjektet tjera»: Deklaratat Udhëzuese Tranzitive», e **Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 11** «Marrëveshjet e Përbashkëta» dhe **Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 12** «Shpalosjet e interesave në subjektet tjera»: Udhëzime tranzicioni

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1.1.2013

Më 28.06.2012, Standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit publikuan një amendament për kërkesat në tranzicion të standardeve të mësipërme. Amendamenti sqaron se “data e aplikimit fillestar”, është fillimi i periudhës së raportimit vjetor në të cilin SNRF 10 është aplikuar për herë të parë. Në rast se konkluzioni i konsolidimit i cili arrihet në datën e aplikimit fillestar është i ndryshëm kur krahasohet me zbatimin e SNK 27 dhe KIS 12, vetëm periudha krahasuese duhet të rregullohet në mënyrë retrospektive. Prezantimi i krahasimeve të përshtatura për periudhat më të hershme është i lejuar por nuk kërkohet. Një përjashtim të ngjashëm në lidhje me prezantimin e krahasimeve të rregulluara është dhënë në kërkesat e tranzicionit të SNRF 11 dhe 12. Gjithashtu, informacionet shpjeguese që lidhen me entitetet jo të konsoliduara të strukturuar nuk janë të nevojshme për çdo periudhë para periudhës së parë vjetore për të cilën është aplikuar SNRF 12.

Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i amendamentit në pasqyrat financiare të saj.

- **Amendamenti i Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 10** «Pasqyrat Financiare të Konsoliduara», të **Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 12** «Shpalosjet e interesave në subjektet tjera» dhe **Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 27** «Pasqyrat Financiare të veçanta»: Enitete Investuese

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1.1.2014

Më 31.10.2012, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi amendamentin e mësipërm i cili definon “enitetet investuese” dhe prezanton një përjashtim për të konsoliduar filiale të veçanta për subjektet e investimeve. Një subjekt investues nuk do të konsolidojë filialët e saj ose të zbatojë SNRF 3 kur ajo merr kontrollin e një njësie tjetër ekonomike. Në vend të kësaj, një subjekt investues do të matë investimin në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me SNRF 9. Ndryshimi i mësipërm nuk zbatohet për filialet që nuk janë të mbajtura për qëllim të marrjes së kthimit nga investimi, por në ofrimin e shërbimeve që lidhen me aktivitetet investuese të shoqëris mëmë. Megjithatë, mëma e një njësie investuese, që nuk është vet një njësi investuese, do të konsolidojë të gjitha subjektet që ajo kontrollon, duke përfshirë edhe ato që kontrollohen nëpërmjet një filiali të njësis investuese.

Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i amendamentit në pasqyrat financiare të saj.

- **Përmirësimet në Standaret Ndërkombëtare të Kontabilitetit**

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë me apo pas 1.1.2013

Si pjesë e projektit të përmirësimeve vjetore, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi më 17.5.2012 amendamentet jo urgjente por të domosdoshme të standardeve të ndryshme. Kompania vlerëson ndikimin e mundshëm nga miratimi i amendamenteve të mësipërme në pasqyrat financiare të saj.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.3 Këmbimi i valutave të huaja

Valuta funksionale dhe e prezantuar

Artikujt e përfshirë në pasqyrat financiare maten duke filluar valutën e hapësirës primare ekonomike në të cilën entiteti operon (“valuta funksionale”). Këto pasqyra financiare janë të prezentuara në Euro, e cila është valuta funksionale dhe prezentuese e Kompanisë.

Transaksionet dhe balancat

Transaksionet e valutës së huaj janë transferuar në valutën funksionale duke përdorur normen e këmbimit që mbizotëron në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet e këmbimit të huaj që rezultojnë nga zgjidhja e transaksioneve të tilla dhe nga transferimi në normat e këmbimit të fund-vitit të aseteve monetare dhe detyrimeve të emëruara në valutën e huaj janë riorganizuar në fitim dhe humbje.

2.4 Kompensimi (Offsetting)

Asetet dhe detyrimet financiare janë kompensuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes ku ekziston e drejta e imponueshme ligjore për të mënjeluar shumat e njohura dhe ka synim për tu vendosur në baza neto, apo për të realizuar asetin dhe në të njëjtën kohë për të shlyer detyrimin

2.5 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur kur ekziston mundësia që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Kompani dhe këto benefite të mund të maten me besueshmëri.

Kompania njeh të ardhurat duke ngarkuar llojet e tarifave në vazhdim:

- Tarifa hyrëse e barabartë me 3% nga shuma totale e kontributeve të paguara në Fondin 1, përpara se kontributet të konvertohen në njësi kontabël;
- Tarifa menaxheriale e barabartë më 1.5% në baza ditore e aseteve totale të Fondit 1;
- Përqindja e interesit të pranuar në asetet e depozituara të Fondit 2 dhe në bazë të vendimeve të menaxhimit.

2.6 Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse për të gjitha interesat e aseteve dhe detyrimeve financiare duke përdorur metodën e interest efektiv.

2.7 Të hyrat dhe komisionet nga tarifat

Të hyrat dhe komisionet nga tarifat njihen në pasqyrën e të ardhuravë gjithpërfshirëse në baza akruale pasi të sigurohet shërbimi.

2.8 Të hyrat nga dividendët

Dividentët njihen në pasqyrën e të ardhuravë gjithpërfshirëse kur është përcaktuar e drëjta e entitetit për të pranuar pagësën.

2.9 Asetet financiare

Kompania i klasifikon asetet e saj sipas kategorive në vazhdim: asetet financiare me vlerë reale përmes fitimit dhe humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet dhe të gatshmet për shitje dhe asetet e mbajtura deri në maturim. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e aseteve financiare në njohjen fillestare.

Asetet financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregëtim dhe ato të përcaktuara në vlerën përmes fitimit ose humbjes në fillim. Aseti financiar është i klasifikuar në këtë kategori nëse fillimisht sigurohet për qëllim të shitjes në kohë të shkurtë ose nëse është e përcaktuar nga menaxhmenti.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të përmendura në tregun aktiv. Ato rrjedhin kur Kompania siguron të holla ose shërbime direkt tek debitori jo me qëllim të tregtimit të të arkëtueshmeve.

**Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)**

Asetet Financiare (vazhdim)

Asetet financiare të gatshme për shitje

Asetet financiare të gatshme për shitje janë ato të cilat konsiderohen të mbahen për një kohë të pacaktuar, që mund të shitën sipas nevojës së likuiditetit ose ndryshimeve në normat e interesit, normat e këmbimit ose çmimet e ekuitetit.

Asetet financiare të mbajtura deri në maturim

Asetet financiare të mbajtura deri në maturim janë asete financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fikse që menaxhmenti i Kompanisë ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë të mbajë deri në maturitet. Nëse Kompania shet një shumë të madhe të aseteve financiare të mbajtura deri në maturim para se të arrijnë datën e maturimit, pastaj e tërë kategoria e këtyre aseteve do të klasifikohet në asetet financiare të gatshme për shitje.

Njohja fillestare e aseteveve financiare

Asetet financiare njihen në datën e zgjedhjes - data në të cilën Kompania merr përsipër të blëjë ose të shes aktivin.

Të gjitha asetet financiare të ndryshme nga asetet financiare të mbajtura në vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjës njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Asetet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitim dhe humbje për periudhën.

Matja pasuese e aseteve financiare

Asetet me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes barten në vlerë të drejtë bazuar në çmimin e tyre të tregut. Huatë dhe të arkëtuëshmet të mbajtuara deri në maturim barten në koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Asetet financiare të gatshme për shitje më pas maten me vlerë të drejtë.

Fitimet dhe humbjet nga ndryshimet në vlerë të kategorisë “Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes” janë të përfshira në fitim ose humbje në periudhën kur kanë ndodhur. Sidoqoftë, interesi i paguar gjatë posedimit të këtyre aseteve është i njohur si të ardhura të interesit.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerë të drejtë të aseteve financiare të gatshme për shitje njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, deri sa asetet financiar nuk njihet ose zhvlerësohet kohë në të cilën fitimet e mbajtura dhe humbjet e grumbulluara të njohura më herët në të ardhurat gjithëpërfshirëse duhet të njiheshin në fitim ose humbje.

Sidoqoftë, interesi i llogaritur duke përdorur metodën efektive të interesit dhe monedhen e huaj pozitive dhe negative fitimet dhe humbjet nga asetet monetare të klasifikuara si të gatshme për shitje njihen në fitim ose humbje për periudhën. Dividentët në letrat e gatshme për shitje njihen në fitim ose humbje në periudhën kur është themeluar e drejta për të pranuar pagesën. Vlerat e drejta të investimeve të kuotuar në tregjet aktive bazohen në çmimet e kuotuar aktuale. Nëse tregu për aset financiar nuk është aktiv (dhe për letra më vlerë të pa kuotuar), kompania themelon vlerën e drejtë duke përdorur metodat e vlerësimit.

Mosnjohja

Asetet financiare nuk njihen kur të drejtat e pranimit të rrjedhës së parasë nga pasqyrat financiare kanë kaluar ose ku kompania ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.10 Zhvlerësimi i aseteve financiare

Asetet e bartura në koston e amortizuar

Kompania vlerëson në çdo pasyqrë të datës së pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një aset financiar është i dëmtuar. Një aset financiar ose një grup i aseteve financiare është i dëmtuar dhe humbjet nga rënia janë kryer vetëm nëse ekziston evidencë objektive e zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të asetit (një “rast humbje”) dhe që rast humbje (ose ngjarje) ka një ndikim në rrjedhat e vlerësuarat monetare të ardhshme të asetit financiar ose grup asetesh financiare që mund të vlerësohen me besueshmëri.

Shuma e humbjes nga zhvlerësimi është llogaritur si diferencë mes vlerës të asetit dhe vlerës aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredititit) e zbritur me normën fillestare efektive të aktivitetit financiar të interesit. Të arkëtueshmet me afat të shkurtër maturimi nuk janë zbritur. Shuma e bartur e asetit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një kompensimi për dëmtim dhe shuma e humbjes nga zhvlerësimi është njohur në fitimet dhe humbjet e tanishme.

Asetet e bartura në vlerë reale

Kompania vlerëson në çdo pasyqrë të datës së pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një aset financiar është i dëmtuar. Rënie e rëndësishme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të asetit financiar nën kosoton e tij është konsideruar si dëshmi objektive në përcaktimin nëse asetet janë të dëmtuara. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston për aktivitetet financiare të vlefshme-për-shitje, humbja kumulative-e matur si diferenca midis kosots së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale njihet në fitimet dhe humbjet aktuale. Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit klasifikohet si e vlefshme-për-rritjen e shitjes dhe rritja mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pas humbjes nga zhvlerësimi të cilat janë të njohura në fitimin ose humbjen e tanishme, humbja nga zhvlerësimi anulohet nëpërmjet fitimeve dhe humbjeve.

2.11 Asetet e patrupëzuara

Programi i kompjuterit

Shpenzimet që lidhen me zhvillimin ose mirëmbajtjen e programeve kompjuterike njihen si shpenzime në momentin që ndodhin. Kostot që lidhen drejtëpërdrejt me produkte programesh të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga Kompania që do të gjenerojnë përfitime ekonomike që tejkalojnë shpenzimet përtej një viti njihen si aktive jo-materiale. Kostot e zhvillimit të programeve kompjuterike të njohura si asete janë amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë një periudhe prej pesë vitesh.

Asetet tjera të patrupëzuara

Shpenzime që fitojnë të drejtë dhe licencë janë kapitalizuar dhe amortizuar duke përdorur metodën lineare gjatë jetes se përdorimit.

2.12 Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet janë bartur në koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar.

Zhvlerësimi ngarkohet mbi një bazë lineare në mënyrë që të ndahet kostoja e vlerësuar e pronës dhe pajisjeve mbi kohën e tyre të përdorimit. Në vazhdim janë normat vjetore të përafërta të aplikuara për artikujt e rëndësishëm të pronës dhe pajisjeve:

Kompjuter	20%
Pajisje të tjera	20%
Aktivitetet e patrupëzara	20%

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

Prona dhe pajisjet (vazhdim)

Blerjet pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të asetit ose janë njohur si një aset veçantë, kur është e përshtatshme, vetëm atëher kur është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhshmen të ndëlidhura me artikullin do të rrjedhin në kompani dhe kur vlera e aktivitetit të blerë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse si shpenzime gjatë periudhes financiare në të cilën ato janë kryer.

Vlera e mbetur e aseteve dhe jeta e përdorimit janë rishikuar, dhe rregulluar nëse është e nevojshme në secilën datë të bilancit të gjendjes.

Shuma bartëse e një aseti është shkruar menjëherë në shumën e rikuperueshme nëse vlera kontabël e aktivitetit është më e madhe së shumta e vlerësuar e rikuperueshme (shënim 2.13).

Fitimet dhe humbjet nga heqjet janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbjë kur ndodhin.

2.13 Zhvlerësimi i aseteve jo financiare

Asetet që janë subjekt i zhvlerësimit/amortizimit rishikohen për zhvlerësim kurdo që ngjarja ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës së drejtë të një aseti minus kostot për shitjedhe vlerës në përdorim.

2.14 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet me afat maturimi me më pak se 90 ditë nga data e blerjes dhe përbëjnë vetëm para dhe plasmanet me bankat.

2.15 Përfitimet e punëtorit

Kompania nuk bën asnjë provision dhe nuk ka obligim shtesë për të paguar pensionet e punonjësve përveç kontributet e paguara në planin pensional shtetëror, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

2.16 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit aktual të pagueshëm dhe tatimit të shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktualisht llogaritet dhe paguhet në përputhje me Ligjin nr 03/L-162. Tatimi final mbi fitimin në normën prej 10 % (2011:10%) është i pagueshëm duke u bazuar në fitimin vjetor të paraqitur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe të rregulluar për artikujt të cilët janë të pa tatueshëm ose të palejuar. Sipas legjislacionit aktual tatimor, humbjet tatimore mund të barten për tu vendosur në pesë vitet e ardhshme pas vitit në të cilin ka ndodhur humbja tatimore.

Tatimi i shtyrë i të ardhurave është dhënë në mënyrë të plotë, duke përdorur metodën e detyrimeve, që rrjedhin nga diferencat e përkohshme ndërmjet bazave tatimore të aseteve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Normat e tatimit të miratuara aktualisht përdoren në përcaktimin e tatimit në të ardhura të shtyra. Tatimi i shtyrë ngarkohet ose kreditohet në pasqyrën e të ardhurave përveç kur ajo lidhet me artikujt e ngarkuar ose kredituar direkt në ekuitet, me ç'rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në ekuitet.

Asetet e tatimit të shtyrë janë njohur deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme.

Kompania nuk ka njohur ndonjë detyrim të shtyrë tatimorë apo aset më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011, pasi nuk ka pa dallime materiale të përkohshme ekzistuese në ato data.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.17 Huatë

Huatë njihen fillimisht me vlerën e tyre reale të flukseve hyrëse të pranuar, minus kosotot e ngarkuara për transkasion. Huatë më pas janë deklaruar me vlerën e tyre të amortizuar të blerjes.

2.18 Kapitali aksionar

a) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

b) Kostot që lidhen me emetimin e aksioneve

Kostot që lidhen më çështjet e aksioneve të reja, opsionet ose aktivitetet e biznesit janë paraqitur në kapital si një reduktim, neto nga tatimi, i të hyrave.

c) Rezervat

Rezervat, të cilat përbëhen nga rivlerësimi dhe rezervat statuore, janë të krijuara gjatë gjithë periudhës, bazuar në fitime/humbje nga rivlerësimi i aseteve financiare dhe jo financiare, sikurse shpërndarja e fitimeve të akumuluar në bazë të rregullatave ligjore dhe vendimeve nga ana e menaxhmentit të Kompanisë.

(e) Fitimet e pashpërndara

Fitimet e pashpërndara përbëhen nga fitimet e pashpërndara nga periudhat aktuale dhe të kaluara.

(f) Dividentët e aksioneve të zakonshme

Dividendi i aksioneve të zakonshme njihet në periudhen kur miratohen nga aksionarët e Kompanisë.

Dividentët për vitin që janë botuar pas datës së balancimit janë shpalosur në shënimin e ngjarjeve të mëvonshme.

2.19 Zotimet dhe kontingjentët

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e larget. Përveq kësaj, një aset kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme do të konfirmojnë se një detyrim i pësuar në datën e pozicionit financiar dhe një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.20 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë definuar si ato palë të cilat kanë kontroll mbi njëri-tjetrin ose që kanë një ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëri tjetrit.

Palët e lidhura të Kompanisë janë Prva Group PLC nga Ljubljana-Sloveni dhe korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët janë aksionarë të kompanisë.

2.21 Ngjarjet pas datës pasuese

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit që nuk janë rregulluar janë shpalosur në shënime kur kanë qenë materiale.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

3 Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Kompanisë janë të ekspozuar ndaj një shumëllojshmërie të rreziqeve financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Qëllimi i Kompanisë është që të arrihet një balancë e përshtatshme mes rrezikut dhe të kthehet për të minimizuar efektet e mundshme negative mbi punën financiare të Kompanisë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Kompanisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur limitet e duhura të rrezikut dhe kontrollet dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve nëpërmjet sistemeve të besueshme të informacionit dhe modern. Kompania rishikon rregullisht politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikata më të mira në zhvillim.

Menaxhimi i riskut kryhet nga menaxhmenti i kompanisë nën politikat e aprovuara nga Bordi Mbikqyrës. Menaxhmenti i identifikon dhe vlerëson rreziqet financiare në bashkëpunim të ngushtë me njësitë e Kompanisë operative. Bordi Mbikqyrës siguron politika dhe procedura të shkruara për menaxhimin e rrezikut të përgjithshëm si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, si risku i këmbimit valutor, norma e interesit të rrezikut.

Përqëndrimi i risqeve të aseteve financiare sipas sektorëve gjeografik

Tabela në vijim paraqet ekspozimin kryesor kreditor të kompanisë në shumat bartëse, të kategorizuara sipas rajonit gjeografik si më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 në Euro.

	Republika e Kosovës	BE	Totali
Asetet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3,895	1,169	5,064
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	181,000	152,592	333,592
Të arkëtueshme tjera	23,776	-	23,776
Më 31 Dhjetor 2012	213,871	153,561	362,432
Më 31 Dhjetor 2011	216,052	155,170	371,222

3.1 Risqet e tregut

Kompania është e ekspozuar ndaj risqeve të tregut. Risqet e tregut dalin nga pozicioni i hapur i Kompanisë ndaj efektit të luhatjeve në nivelin dominues të normave të tregut të interesit, si dhe nga efekti i luhatjeve në normat e këmbimit të valutave të huaja. Menaxhmenti i Kompanisë vendos limitet e vlerës së riskut që mund të pranohet, i cili është kryesisht i bazuar në monitorim të përditshëm.

Risku kreditor

Vlera e bartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit të kredisë. Ekspozimi maksimal i kredisë ndaj riskut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	2012	2011
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	5,064	29,526
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	333,592	315,491
Të arkëtueshme tjera	23,776	26,205
Më 31 Dhjetor	362,432	371,222

Risku i normës së interesit

Kompania është e ekspozuar ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset e mjeteve monetare.

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e kompanisë ndaj rrezikut të normës së interesit. Pozicioni i kompanisë në aspektin e ndryshimit ndaj ndryshimeve të normave të interesit në momentin e ri-vendosjes së normës së interesit më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 është paraqitur më poshtë. Përfshihen instrumentet financiare të kompanisë në vlerën e tyre aktuale, bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit (në Euro):

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

Risku i normës së interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2012	Më pak se 1 muaj	Prej 1 deri 3 muaj	Prej 3 deri 12 muaj	Prej 1 deri 5 vite	Më shumë se 5 vitë	Që nuk bartin interes	Totali
Asetet							
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5,064	-	-	-	-	-	5,064
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	-	328,874	-	4,718	333,592
Të arkëtueshme tjera	-	-	-	-	-	23,776	23,776
	5,064	-	-	328,874	-	28,494	362,432
Detyrimet							
Detyrimet tregtare dhe të tjera	-	-	-	-	-	6,849	6,849
	-	-	-	-	-	6,849	6,849
Hapësira e rrezikut të normës së interesit neto	5,064	-	-	328,874	-	21,645	355,583
31 Dhjetor 2011							
Totali i aseteve	29,526	-	-	310,674	-	31,022	371,222
Totali i detyrimeve	-	-	-	-	-	12,465	12,465
Hapësira e normës së interesit neto	29,526	-	-	310,674	-	18,557	358,757

Risku i monedhes

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhes së huaj pasi që të gjitha transaksionet e saj kryhen në monedhen vendase.

3.2 Risku i likuiditetit

Kompania është e ekspozuar ndaj kërkesave të përditshme mbi burimet e parave të gatshme në dispozicion nga llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat maturimi, zbrazjeve të huave dhe tërheqjeve tjera të parave.

Tabelat e mëposhtme analizojnë aktivet dhe pasivet e kompanisë, të grupuara sipas maturitetit të tyre përkatës, bazuar në periudhën e mbetur në datën e pozicionit financiar deri në datën kontraktuale të maturimit (në Euro).

31 Dhjetor 2012	Më pak se një muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Asetet						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5,064	-	-	-	-	5,064
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	-	4,718	328,874	-	333,592
Të arkëtueshme tjera	-	-	23,776	-	-	23,776
Totali i aseteve	5,064	-	28,494	328,874	-	362,432
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	-	-	6,849	-	-	6,849
Totali i detyrimeve	-	-	6,849	-	-	6,849
Hapësira neto e likuiditetit	5,064	-	21,645	328,874	-	355,583
31 Dhjetor 2011						
Totali i aseteve	29,526	-	31,022	310,674	-	371,222
Totali i detyrimeve	-	-	12,465	-	-	12,465
Hapësira neto e likuiditetit	29,526	-	18,557	310,674	-	358,757

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

3.3 Vlerësime dhe gjykime kritike kontabël

Kompania bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë shumat e raportuara të asetëve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe bazuar në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë parashikimet e ngjarjeve të ardhshme që besohet se janë të arsyeshme sipas rrethanave.

Vlera e drejtë e letrave me vlerë jo të kuotuar në tregun aktiv

Vlera e drejtë e letrave me vlerë të tilla të pa kuotuar në një treg aktiv mund të përcaktohet nga Kompania duke përdorur burime të respektuar të çmimeve (të tilla si agjenci çmimesh) ose çmimet treguese nga obligacionet/borxh e tregut. Komisioneri citon se të arriturat nga burimet e çmimeve mund të jenë tregues dhe jo ekzekutues ose të detyrueshëm. Kompania do të ushtrojë gjykimin dhe vlerësimet për sasinë dhe cilësinë e burimeve të çmimeve të përdorura. Kur nuk ka të dhëna të tregut në dispozicion, Kompania mund të vë çmim për pozicionet duke përdorur modelet e veta, të cilat janë zakonisht të bazuara në metodat e vlerësimit dhe teknikat e njohur përgjithësisht si standard përbrenda industrisë. Inputet në këto modele janë kryesisht të fituar shumëfish dhe flukset e parasë të skontuara. Modelet e përdorura për të përcaktuar vlerat e drejta janë të vlefshme dhe të rishikuara në mënyrë periodike nga ana e personelit më përvojë, të pavarur nga pjesa që ka krijuar ato. Modelet e përdorura për letrat me vlerë të kapitalit privat janë të bazuar kryesisht në të ardhurat e shumëfishta (bazuar në të ardhurat historike të emetuesit gjatë dekadës së kaluar) dhe flukset e parasë të skontuara. Modelet e përdorura për letrat me vlerë të borxhit janë bazuar në vlerën neto aktuale të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme, të përshtatura sipas nevojës për likuiditet, dhe e kreditit dhe faktorët e rrezikut të tregut.

Modelet përdorin të dhëna të vëzhgueshme, në një masë të realizueshme. Megjithatë, fusha të tilla si e rrezikut të kredisë (të dyja dhe pala tjetër), luhatjet dhe korelacionet kërkojnë menaxhmentit për të bërë vlerësime. Ndryshimet në supozimet për këta faktorë mund të ndikojnë në vlerën e raportuar të drejtë të intrumenteve.

3.4 Vlerësimi i vlerës reale

Vlera reale paraqet shumën me të cilën një aset mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në baza duarlibër. Vlerat reale janë bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas profilit të asetit dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të matura më vlerën e drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki mbledh asetet dhe detyrimet financiare në tre nivele të cilat bazohen në rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së asetëve:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për mjetet ose detyrimet identike;
- **Niveli 2:** të dhënat tjera hyrëse, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për asetin ose detyrimin e respektuar të drejtpërdrejt (dmth si çmimet), ose tërthorazi (psh. bërë nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat hyrëse mbi aktiv ose pasiv që nuk janë bazuar në të dhënat në dispozicion për vëzhgimin e tregut.

Letra me vlerë të gatshme për shitje njihen sipas vlerës së tyre reale bazuar në çmimin e tyre në treg në datën e Pasqyrës së Pozicionit financiar.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

Vlerësimi i vlerës reale (vazhdim)

Instrumentet financiare jo të matura më vlerën reale

Tabela në vijim përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të këtyre asetëve dhe detyimeve financiare që nuk janë të paraqitura në pasyqrën e pozicionit financiar në vlerën e tyre të drejtë (në Euro).

	Shënimë	Huatë dhe te arketuëshmet	Të mbajtura deri në maturim	Kosto tjera të amortizimit	Vlera bartësë	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2012						
Asetet						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	9	5,064	-	-	5,064	5,064
Letrat më vlerë të mbajtura deri në maturim	10	-	333,592	-	333,592	333,592
Të arkëtueshme tjera	13	23,776	-	-	23,776	23,776
		28,840	333,592	-	362,432	362,432
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	14	-	-	6,849	6,849	6,849
		-	-	6,849	6,849	6,849
31 Dhjetor 2011						
Asetet						
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	9	29,526	-	-	29,526	29,526
Letrat më vlerë të mbajtura deri në maturim	10	167,817	147,674	-	315,491	315,491
Të arkëtueshme tjera	13	26,205	-	-	26,205	26,205
		223,548	147,674	-	371,222	371,222
Detyrimet						
Detyrimet tregtare dhe të tjera	14	-	-	12,465	12,465	12,465
		-	-	12,465	12,465	12,465

Huatë dhe avanset

Huatë dhe të arkëtueshmet barten në koston e amortizuar minus provizioni për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejt korrespondon tek vlera e tyre bartëse.

Letrat më vlerë të mbajtura deri në maturim

Vlera e drejtë e aktiveve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv është e vendosur duke përdorur supozimet në bazë të kushteve të tregut ekzistues në çdo datë të bilancit të gjendjes.

Asetet tjera financiare

Vlera e drejt e mjeteve monetare që përfshin paranë dhe ekuivalentet e parasë konsiderohet e përafërt me vlerat e tyre kontabël sipas definicionit dhe për shkak të maturisë së tyre më pak se 3 muaj.

Të pagueshmet tjera

Vlera bartëse e të pagueshmeve të tjera përafron vlerën e tyre të drejtë për shkak të maturitetit të tyre më pak se 3 muaj.

3.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Kompanisë për sa i përket menaxhimit të kapitalit janë:

- Të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e kapitalit nga rregullatori,
- Të ruajë aftësinë e Kompanisë që të vazhdojë të operojë si entitet funksionues, dhe
- Të mbajë një bazë të fortë të kapitalit për të mbështetur zhvillimin e bizneseve të saj.

Kompania është e obliguar të menaxhojë strukturën e kapitalit të saj e cila përbëhet nga borxhi, paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe kapitali i kontribuar i zotëruesve të kapitalit, përfshirë kapitalin e paguar dhe fitimet e mbajtura.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

4 Tarifa e menaxhimit për Fondin 2	2012	2011
Tarifa e menaxhimit –Fondi pensional i KEK	-	6,939
Tarifa e menaxhimit –Fondi pensional i PTK	10,834	21,452
	10,834	28,391
5 Të hyrat e interesit	2012	2011
Të hyrat e interesit nga letrat me vlerë të gatshme për shitje		664
Të hyrat e interesit nga depozitimet	7,912	69,214
	7,912	69,878
6 Të hyrat tjera	2012	2011
Fitimet nga shitja e pajisjeve tjera (Shënimi 13)	-	2,577
Të hyrat tjera	552	4,610
	552	7,187
7 Shpenzimet operative	2012	2011
Pagat dhe kostot e tjera të personelit	53,974	94,493
Zhvlerësimi dhe amortizimi (Shënim 13,14)	12,504	41,305
Shpenzimet administrative	11,348	24,367
Shpenzimet financiare, këshilluese dhe mirëmbajtja e llogarisë	10,032	11,759
Shpenzimet e qirasë	6,574	10,386
Shpenzimet e komunikimit	4,708	8,097
Shpenzimet e shërbimit lidhur më palët ndërlidhëse	3,726	5,976
Shpenzimet e karburantit	2,100	3,668
Ngarkesat e bankës	1,264	2,973
Taksat (interesi, qeraja)	592	860
Marketing dhe reklamë	75	4,674
Shpenzimet tjera	4,323	7,348
	111,220	215,906

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

8 Shpenzimet e tatimit në të ardhura

	2012	2011
Fitimi para tatimit	(6,154)	(18,788)
Tatimi në normën prej 10% (2011: 10%)		-
<i>Rregulluar për ndikime tatimore në:</i>		
Shpenzimet e palejuara për qëllime tatimore		218
Të ardhura jo tatimore për qëllime tatimore		-
Artikuj tjerë jo tatimorë-duke mbajtur tatimin e paguar	(9,945)	(7,055)
Humbjet tatimore të bartura përpara	-	-
Tatimi i kompensuar i të ardhurave	9,945	7,055
Shpenzimet tatimore		-

9 Paraja dhe ekuivalentet e parase

	2012	2011
Paraja e gatshme	363	149
Llogari rrjedhëse- Kasabank	688	4,017
Llogari rrjedhëse - Raiffeisen Bank, Kosovë	1,284	13,272
Llogari rrjedhëse – Banka Qendrore Kosovë (BQK)	188	212
Llogari rrjedhëse - Pro Credit Bank	-	2,900
Llogari rrjedhëse - Banka Ekonomike	27	247
Llogari rrjedhëse – TEB	1,345	5,749
Llogaria e ruajtjes – Poteza	1,169	2,980
	5,064	29,526

10 Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim

	2012	2011
Letrat me vlerë të borxhit	147,874	147,674
Plasmanet në banka	181,000	163,000
Interesi i përlogaritur	4,718	4,817
	333,592	315,491

	2012	2011
<u>Letrat me vlerë të borxhit</u>		
- Obligacionet e korporatës	108,743	120,839
- Obligacionet qeveritare	39,131	26,835
	147,874	147,674

Vendosjet me bankat

	2012	2011
Vendosjet me banka-TEB	131,000	113,000
Vendosjet me banka-NLB Kasabank	50,000	50,000
	181,000	163,000

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

11 Prona dhe pajisjet

	Kompjuterët dhe pajisjet tjera	Totali
Kosto:		
Më 1 Januar 2011	90,129	90,129
Shtesat	6,096	6,096
Heqjet	(6,000)	(6,000)
Më 31 Dhjetor 2011	90,225	90,225
Shtesat	524	524
Më 31 Dhjetor 2012	90,749	90,749
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Më 1 Januar 2011	67,921	67,921
Ngarkimi për vit	17,354	17,354
Eliminimi në heqje	(2,277)	(2,277)
Më 31 Dhjetor 2011	82,998	82,998
Ngarkimi për vit	2,227	2,227
Më 31 Dhjetor 2012	85,225	85,225
Vlera neto në libra:		
Më 31 Dhjetor 2012	5,524	5,524
Më 31 Dhjetor 2011	7,227	7,227

12 Asetet e paprekshme

Për 31 Dhjetor 2012 Asetet e patrupëzuara përbëhen prej shpenzimeve kapitale për blerje të programeve kompjuterike. Lëvizjet e vlerës bartese janë siq vijon:

	Programi kompjuterik	Totali
Kosto:		
Më 1 Janar 2011	119,753	119,753
Shtesat	-	-
Heqjet	-	-
Më 31 Dhjetor 2011	119,753	119,753
Shtesat	9,000	9,000
Më 31 Dhjetor 2012	128,753	128,753
Zhvlerësimi i akumuluar:		
Më 1 Janar 2011	79,757	79,757
Ngarkimi për vit	23,951	23,951
Më 31 Dhjetor 2011	103,708	103,708
Ngarkimi për vit	10,277	10,277
Më 31 Dhjetor 2012	113,985	113,985
Vlera neto në libra:		
Më 31 Dhjetor 2012	14,768	14,768
Më 31 Dhjetor 2011	16,045	16,045

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
 (Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

13 Të arkëtueshmet tjera

	2012	2011
Të arkëtueshmet e tarifave të menaxhmentit	9,489	15,271
Të arkëtueshmet nga tarifa e hyrjes dhe daljes	1,107	1,912
Parapagimet	3,235	1,967
Parapagimi tatimor	9,945	7,055
	23,776	26,205

14 Detyrimet tregtare dhe të tjera

	2012	2011
Furnitorët	2,396	9,767
Detyrimet ndaj fondit	3,548	1,964
Detyrimet për Kontributin pensional dhe Tatimin mbi të ardhurat personale	848	734
Të tjera	57	-
	6,849	12,465

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

15 Ekuiteti

Kapitali aksionar

Më 31 Dhjetor 2012, sipas librit të aksionarëve në pasqyrën e pozicionit financiar, vlera totale e kapitalit aksionar arrin shumën në 400,000 Euro (31 Dhjetor 2011: 4,000,000 Euro).

Struktura e kapitalit aksionar të Kompanisë sipas librit të aksionarëve për 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 është si në vijim:

	2012	2011
Prva Group PLC, Slovenia	67.40%	67.40%
Dukagjini Sh.p.k., Peja, Republika e Kosovës	32.60%	32.60%
	100.00%	100.00%

Asambleja e Përgjithshme e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve në mbledhjen e mbajtur më 11 Prill 2011 ka vendosur të zvogëlojë kapitalin e regjistruar në 3,600,000 Euro. Me këtë vendim, Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të përdor vetëm Licencën për Fondin Suplementar Pensional për Individë dhe të kthejë Licencën e Menaxhimit të Asetit.

Prandaj Bordi Ekzekutiv i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës më 12 Janar 2012 ka marrë vendim të tërheq licencën për Menaxher Asetesh nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve, dhe të vazhdojë licencën për Fondin Suplementar Pensioneve Individualë.

Kompania është e regjistruar në Agjensionin Kosovar për regjistrim të biznesit të Republikës së Kosovës me numër të dosjës 70378739 të datës 04 Shtator 2006. Sipas dosjës së regjistrimit, e cila është e rifreskuar menjëher pas tërheqjes së kapitalit prej 3,600,000 Euro më 14 Korrik 2011, totali i kapitalit aksionar arrin shumën prej 400,000 Euro prej të cilave Prva Pokojninska Druzhba D.D ka paguar 269,600 Euro ose 67.4% dhe Dukagjini Sh.p.k ka paguar 130,400 Euro ose 32.6% nga totali i regjistruar i kapitalit aksionar.

.

16 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Balancet dhe transaksionet e rëndësishme të palëve të ndërlidhura janë paraqitur siq vijon:

	2012	2011
Detyrimet	3,538	2,880
Të ardhura	87,056	99,916
Shpenzimet	5,314	11,256
Blerje softverike	9,000	
	2012	2011
Pagesat e personelit menaxherial	21,570	31,464
	21,570	31,464

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Euro përveç nëse është e theksuar ndryshe)

17 Kontingjentët

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2012 nuk është llogaritur provizion për humbjet e mundshme të ndërlidhura me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Kompanisë, rregullisht analizon risqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me seancat gjyqësore dhe pretendimet e mundshme me synim kundër Kompanisë, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultatet e këtyre çështjeve nuk mund të caktohen me saktësi, menaxhmenti i Kompanisë beson se nuk ka gjasa që të rezultojnë detyrime materiale.

Detyrimet tatimore

Pasqyrat financiare dhe regjistrat kontabël të Kompanisë nuk janë audituar nga autoriteti tatimor për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012. Kompania iu është nënshtruar të gjitha rregullave dhe rregulloreve tatimore gjatë llogaritjes së detyrimeve tatimore, sido që të jetë interpretimet tatimore sipas autoriteteve tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga Kompania.

Zotimet operative të qirasë

Më 31 Dhjetor 2012 është një marrëveshje e qirasë për godina biznesore për periudha kohore të padefinuara, pagesa mujore neto është 400 Euro.

18 Ngjarjet pas datës raportuese

Pas 31 Dhjetor 2012 – data raportuese deri në aprovimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka ngjarje rregullative që reflektojnë në pasqyrat financiare ose në ngjarje që janë me rëndësi materiale për shpalosje në këto pasqyra financiare.